



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 32/P2 Prot.

Kuçovë, më 26.09. 2023

V E N D I M

Nr. 23, datë 26/09/2023

Për

“Miratimin e Dhënies së Ndhmës Financiare për familjen e përmbytur nga reshjet e shumta të datës 16 .06.2023, për Përballimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësi Natyrore”.

Këshilli Bashkiak Kuçovë në mbledhjen e tij të datës _____.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin nr. 64 pika a dhe c, te ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, mbështetur në ligjin nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim te V.K.M- së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” .”. Mbështetur në shkresën nr.603/1 Prot. datë 04.07.2023 nga Këshilli i Qarkut Berat, protokolluar në institucionin tonë me nr. 2107/1 Prot. datë 06.07.2023.

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të emergjencës sipas preventivit të hartuar nga Këshilli i Qarkut Berat për banesën e **Z. Gëzim Braçja** ,vlerësimin e dëmit me shumën **59,000** lekë, ku në zbatim të ligjit të sipërpërmendur do të dëmshpërblehen me 50% të shumës së preventivit, ku shuma përfituese është **29,500** lekë.
2. Dhënien e ndihmës financiare për banesën e **Z. Gëzim Braçja** , të dëmshpërblehet nga Bashkia Kuçovë.

3. Ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua 19 vota pro; — kundër; — abstenim;
11 këshilltaret prezent

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU

